



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Maliq, më 22.07.2024

PROJEKT VENDIM - NR 2

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN
E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR DHE KRIJIMIN, ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR TË BASHKISË MALIQ”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 57/2020 “Për Pyjet”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...”, VKM nr.1080,dt.22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve”, të ligjit nr. 45/2016 neni 9 dhe 10, “Për vullnetarizmin”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 17.7.2019, “Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit”, të Urdhrit nr. 299, datë 6.11.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e librezës së vullnetarizmit”, të Urdhrit nr. 300, datë 6.11.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të kontratave të vullnetarizmit”, me propozim të kryetarit të Bashkisë,

I propozojmë Këshillit të Bashkisë :

1. Të miratojë planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në Fondin Pyjor/Kullosor të Bashkisë Maliq.
2. Në cilësinë e ofruesit dhe përfituesit të vullnetarizmit, pranë Bashkisë Maliq, të krijohet “Shërbimi Vullnetar i Bashkisë Maliq”.
3. Shërbimi Vullnetar i Bashkisë Maliq organizohet pranë Sektorit të Emergjencave Civile, Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave dhe ofron vullnetarizëm në fushat si më poshtë:
 - d) Mbrojtja e mjedisit:
 - iv. Pastrimi i mjediseve dhe parqeve publike të ndotura nga hedhja e pakujdesshme e mbetjet urbane,
 - v. Informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për rreziqet e mundshme të ndotjes urbane dhe mënyrën e mbrojtjes së mjedisit,
 - vi. Kryerja e fushatave të pyllëzimit.
 - e) Mbrojtja dhe përkujdesja sociale:
 - iii. Mbledhja dhe shpërndarja e ndihmave për familjet në nevojë,
 - iv. Dhënia e mbështetjes për shërbime lehtësuese ndaj moshës së tretë dhe personave me aftësi të kufizuara.
 - f) Mbrojtja nga zjarri në pyje:

- iv. Vëzhgimi dhe sinjalizimi i zjarreve në pyje,
- v. Vëzhgimi i zonave pyjore për rreziqe të mundshme të cilat mund të shkaktojnë zjarr,
- vi. Dhënia e mbështetjes së autoriteteve lokale për shuarjen e zjarreve,

4. Sektori i Emergjencave Civile, Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, përgjigjet për:

- k) Regjistrimin e vullnetarëve;
- l) Regjistrimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë apo kërkojnë të ofrojnë vullnetarizëm brenda territorit administrativ të bashkisë Maliq;
- m) Organizimin e vullnetarëve në “Skuadra vullnetare”, me përbërje 10-15 anëtare, sipas fushës së vullnetarizmit që do të ofrohet;
- n) Përgatitjen e planit të aktiviteteve të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq .
- o) Bashkëndimin e veprimtarisë me drejtoritë e bashkisë për identifikimin e nevojave për vullnetarizëm dhe kryerjen e aktiviteteve të vullnetarizmit;
- p) Bashkëndimin e veprimtarisë me “Skadrat vullnetare” dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara, për ofrimin e vullnetarizmit;
- q) Monitorimin dhe vlerësimin e shërbimit vullnetar;
- r) Organizimin e trajnimit të vullnetarëve;
- s) Pajisjen me uniformë, vegla e pajisje të domosdoshme pune sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e vullnetarizmit;
- t) Përgatitjen e projekt-raportit vjetor mbi gjendjen e vullnetarizmit në Bashkinë Maliq.

5. Vullnetar i Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq mund të bëhet:

- d) Çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm;
- e) Çdo person me aftësi të kufizuara, i cili mund të kryejë vullnetarizëm, në përputhje me aftësitë dhe zhvillimin e tij fizik e mendor;
- f) Çdo i mitur i moshës 15 deri 18 vjeç, kur prindi ose përfaqësuesi i tij ligjor ka dhënë pëlqimin me shkrim për lidhjen e kontratës (ose formularin e vetdeklarimit).

6. Të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq, janë ato të përcaktuara në ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për vullnetarizmin.

7. Për tu regjistruar si vullnetar i Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq, çdo person duhet të të paraqes pranë bashkisë këto dokumente:

- f) Kërkesë me shkrim ku të përcaktohet fusha e vullnetarizmit që dëshiron të ofrojë;
- g) Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës;
- h) Jetëshkrimin;
- i) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- j) Çdo dokument tjetër që dëshmon aftësitë në kuadër të angazhimit të tij si vullnetar.

8. Organizatat jofitimprurëse të cilat dëshirojnë të ofrojnë vullnetarizëm në territorin administrativ të Bashkisë Maliq, duhet të deklarojnë objektin dhe qëllimin e vullnetarizmit dhe të dorëzojnë për regjistrim, dokumentet si më poshtë:

- e) Kërkesën për ofrim vullnetarizmi ose njoftimin për ofrim të vullnetarizmit për rastet kur organizata është e autorizuar të kryej vullnetarizëm nga institucioni i prefektit, një institucion qendror ose ministri e linjës;
 - f) Dokumentin ligjor të regjistrimit si organizatë jofitimprurëse;
 - g) Ekstraktin historik të lëshuar nga organi publik kompetent;
 - h) Projektin ose planin për kryerjen e vullnetarizmit, si dhe përshkrimin e rezultateve të pritshme.
9. Sektori i Emergjencave Civile, Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave pasi verifikon saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe përmbushjen e kriterëve ligjorë të kërkuarit për vullnetarizëm:
- f) I paraqet vullnetarit “Formularin e Deklarimit të Vullnetarizmit” për plotësim, sipas Lidhjes 1 të këtij vendimi, e cila nënshkruhet nga vullnetari dhe drejtuesi i njësisë përgjegjëse për shërbimin vullnetar në bashki.
 - g) Kryen regjistrimin e vullnetarit në Regjistrin e Vullnetarëve të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq, sipas Lidhjes 2 të këtij vendimi;
 - h) Kryen regjistrimin e organizatës jofitimprurëse si ofrues vullnetarizmi në Bashkinë Maliq sipas Lidhjes 3 të këtij vendimi;
 - i) Lëshon vërtetimin për regjistrimin e personit si vullnetar të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq;
 - j) Lëshon vërtetimin për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse si ofrues vullnetarizmi në Bashkinë Maliq.
10. Shërbimi Vullnetar i Bashkisë Maliq aktivizohet dhe drejtohet nga Sektori i Emergjencave Civile, Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave (struktura e përcaktuar në pikën 2).
11. Për numrin, përbërjen dhe fushën e veprimtarisë së Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq, të informohet çdo vit institucioni i Prefektit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punës,
12. Përgjigjet për zbatimin e këtij vendimi: drejtoritë në bashkinë Maliq, vullnetarët e Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Maliq, dhe organizatat jofitimprurëse që ofrojnë vullnetarizëm në territorin administrativ të bashkisë.
13. Ky projekt-vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Maliq, më 22.04.2024

RELACION

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN
E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR DHE KRIJIMIN, ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR TË BASHKISË MALIQ”**

Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota.

Me transferimin e fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave” Bashkisë i linden detyrimet ligjore për menaxhimin dhe kontrollin e fondit pyjor dhe kullosor që ka në pronësi. Me ndryshimet që ju bënë ligjit të vjetër të pyjeve Ligji 9385 Për pyjet dhe shërbimin pyjor struktura menaxhuese e fondit pyjor dhe kullosor në Bashki në zbatim të Nenit 20 pika 5 “Strukturat e organeve të shërbimit pyjor përgatisin skemën për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve, ku përcaktohen vazhdimësia dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre, masat për mbrojtjen e pyjeve dhe të mjedisit pyjor nga ndotja atmosferike, ruajtja e ekuilibrave të sistemeve ekologjike natyrore, duke shmangur sëmundjet dhe shfaqjen e insekteve në pyje, si dhe masat parandaluese nga zjarri”. Ky plan masash është hartuar nga Struktura e Pyjeve dhe Kullotave në Bashki çdo vit, është miratuar nga titullari i Bashkisë dhe ju është dërguar për bashkëpunim dhe koordinim dhe institucioneve të tjera si Zjarrfikësja Maliq, Prefektura, etj. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri 57/2020 “Për Pyjet”, Neni 30, pika 4, geramat: b) “struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre... c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre.

Ngritja dhe organizimi i shërbimit vullnetar në bashki

Neni 38, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, i kushton një rëndësi të veçantë rolit të shërbimit vullnetar të mbrojtjes civile, duke e përcaktuar atë si një nga strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Për ngritjen e shërbimit vullnetar në bashki, autoritetet lokale, duhet të mbajnë në konsideratë dhe të njojnë ndryshimi midis “vullnetarit” dhe “vullnetarit të mbrojtjes civile”.

Ndryshimet	Vullnetari	Vullnetari i mbrojtjes civile
Kquadri ligjor	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, - VKM nr. 506, datë 17.7.2019, “Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit”. - Urdhër nr. 299, datë 6.11.2018, i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e librezës së vullnetarizmit”. - Urdhër nr. 300, datë 6.11.2018, i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të kontratave të vullnetarizmit”. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. - VKM nr. 667, datë 10.11.2021 “Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile, apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive”. <p><i>Kquadri ligjor/ nënligjor është në proces plotësimi.</i></p>
Qëllimi	Të rris angazhimin dhe pjesëmarrjen e individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe të zhvilloj vlerat e solidaritetit njerëzor.	Të rris angazhimin dhe kontributin e qytetarëve në aktivitete të mbrojtjes civile, apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
Kush mund të jetë vullnetar	<ul style="list-style-type: none"> - çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm; - çdo person me aftësi të kufizuara, i cili mund të kryejë vullnetarizëm, në përputhje me aftësitë dhe zhvillimin e tij fizik e mendor; - çdo i mitur i moshës 15 deri 18 vjeç, sipas përcaktimeve të ligjit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi dhe kontribuon vullnetarisht në menaxhimin e fatkeqësive dhe në zvogëlimin e pasojave të tyre. <p>Kategoritë e përjashtuara</p> <ul style="list-style-type: none"> a) personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për ta; b) personat me probleme shëndetësore; c) gratë shtatzëna, nënat me fëmijë nën 10 vjeç dhe prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën 15 vjeç; ç) personat nën 18 dhe mbi 65 vjeç.
Ofruesi i vullnetarizmit	<ul style="list-style-type: none"> - Ofruesi i vullnetarizmit mund të jetë një organ publik, bashkësi fetare ose organizatë jofitimprurëse. - Ofruesi i vullnetarizmit mund të jetë edhe një person juridik vendas ose i huaj, i cili në ofrimin e 	Vullnetarët mund të ofrohen individualisht apo në grupe të organizuara, si struktura jofitimprurëse, por në të gjitha rastet, në varësi të situatave të krijuara dhe të nevojave të sistemit të mbrojtjes civile, detyrat e tyre caktohen nga

	vullnetarizmit, në përputhje me këtë ligj, nuk synon veprimtari fitimprurëse.	institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile. (Është në proces plotësimi kuadri ligjor/nënligjor.)
Përfituesi i vullnetarizmit	- Përfituesi i vullnetarizmit mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas ose i huaj - Përfituesi i vullnetarizmit mund të jetë në të njëjtën kohë edhe ofrues i vullnetarizmit.	Nuk është e përcaktuar (Është në proces plotësimi kuadri ligjor/nënligjor.)
Kohëzgjatja e vullnetarizmit	- Kohëzgjatja ditore e vullnetarizmit është jo më shumë se 5 orë në ditë. - Kohëzgjatja javore e vullnetarizmit është jo më shumë se 25 orë në javë	Nuk është e përcaktuar (Është në proces plotësimi kuadri ligjor/nënligjor.)

Për aq kohë sa kuadri ligjor dhe nënligjor për organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të mbrojtjes civile nuk është plotësuar ende, bashkia mund të ngrejë dhe organizojë vetëm “shërbimin vullnetar” në përputhje me parimet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”. Angazhimi i bashkive në krijimin dhe organizimin e “shërbimit vullnetar” është një hap shumë i rëndësishëm për krijimin në të ardhmen të “shërbimit vullnetar për mbrojtjen civile”, pasi ky angazhim do t’u mundësojë atyre krijimin e përvojës së nevojshme dhe rritjen e aftësive për të ngritur, organizuar dhe menaxhuar me efektivitet “shërbimin vullnetar të mbrojtjes civile”.


Modeli i një vendimi të këshillit bashkiak për ngritjen e Shërbimit Vullnetar në Bashki dhe modeli kontratës së vullnetarizmit pasqyrohet në aneksin A dhe B, bashkëlidhur.

Bashkëlidhur me këtë relacion do të gjeni:

Planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në Fondin Pyjor/Kullozor të Bashkisë Maliq hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

Konceptoi


P. Theodhosi



Dt. 22.04/2024

Konceptoi


K.Brako



Dt. 22.04/2024

Konceptoi

S.Belishta



Dt. 22.04/2024

KRYETARI I BASHKISË

